

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, me gjyqtarin Misin Frangu dhe procesmbajtësen Arbelinda Tahiri, në çështjen juridike, sipas padisë së paditësit [REDACTED] nga fshati [REDACTED] Komuna Ferizaj, kundër të paditurës [REDACTED], [REDACTED] të cilën me autorizim e përfaqëson [REDACTED], për çështjen e pagesave përcjellëse dhe jubilarë, në prezencën e paditëses dhe të përfaqësuesit të të paditurës, në shqyrtimin e mbajtur me datë 06.09.2017, merr këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET, kërkesëpadia e paditësit [REDACTED] nga fshati [REDACTED] Komuna Ferizaj, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura [REDACTED] e [REDACTED] që t'i paguaj paditëses në emër të tri pagave jubilarë për në pension në shumë prej 1158 €, dhe tri pagave përcjellëse me rastin e pensionimit, në shumë prej 1158 €, në shumën totale prej 2.316.00 €, me kamatë që paguan banka për depozitim mbi një vit, si dhe ka kërkuar pagimin e shpenzimeve gjyqësore-taksës gjyqësore prej 20 €, si tërësisht e pa bazuar.

II. Secila palë i bart shpenzimet veta.

A r s y e t i m i

Paditësi [REDACTED] nga fshati [REDACTED] Komuna Ferizaj, si në padinë e parashtruar me datë 25.01.2016, ashtu edhe në shqyrtimin kryesor, ka kërkuar që gjykata të aprovoj kërkesëpadinë e paditëses dhe të detyrohet e paditura [REDACTED] që t'i paguaj paditëses, në emër të tri pagave jubilarë për në pension dhe tri pagave përcjellëse me rastin e pensionimit shumën totale prej 2316.00 €, me kamatë që paguan banka për depozitim mbi një vit, si dhe ka kërkuar pagimin e shpenzimeve gjyqësore-taksës gjyqësore prej 20 euro. Në fjalën përfundimtare paditësi ka deklaruar se nga provat e administruara në shqyrtimin e sotëm gjyqësorë dhe të cilat gjinden në shkresat e lëndës vërtetohet se unë kam punuar në arsim mbi 42 vite, dhe jam pensionuar nga Shkolla Filllore "[REDACTED]" me datë 01.10.2014, ndërsa kam qenë i punësuar që nga viti 1969. Unë Konsideroj se kërkesë padia ime është e bazuar sipas dispozitave të nenit 36 par.9 dhe 10 të Kontratës Kolektive, e cila ka hyrë në fuqi me 2014 dhe

në bazë të këtyre rregullave konsideroj se më takojn tri paga përcjellëse dhe tri paga jubilarë. Kërkoj nga Gjykata që ta detyroj të paditurën që të bëjë pagesën e tri pagave përcjellëse pas pensionimit në shumë prej 1158 € dhe tri paga jubilarë në shumë prej 1158 €, në shumë të përgjithëshme prej 2316 €. I ka Propozuar Gjykatës që kërkespadia të aprovohet në tërësi si e bazuar.

Përfaqësuesi i të paditurës, [REDAKTUAR] në Ferizaj, në përgjigjen e dhënë me shkrim, pranë së cilës ka ngelur edhe në shqyrtimin kryesor, ka propozuar që padia e parashtruar të shpallet e pabazuar, me arsyetimin se konform dispozitave ligjore të ligjit të punës në momentin e mbushjes së moshës 65 vjeqare i ndërprehet marrëdhënja e punës sipas fuqisë së ligjit. Padiësi në referatin e padisë ka deklaruar se marrëdhënja e punës sipas fuqisë ligjore e ka përfunduar me 01.04.2014, kurse pretendimet e tij se gëzon të drejtën e realizimit të tri pagave jubilarë dhe tri pagave përcjellëse janë kërkesa që bien ndesh me dispozitat e kontratës kolektive gjerësisht të nenit 51 të kësaj kontrate kolektive të cilat kanë komplikime financiare fillojnë të zbatohen nga data 01.01.2015, ndërsa dispozitat e tjera fillojnë të zbatohen menjëher. Nga kjo dispozitë rezulton fakti se padiësi nuk i ka fituar të drejtat që burojnë nga kjo kontratë kolektive, se padiësi me 01.10.2014, është pensionuar ku e sjellim edhe formularin e nënshkruar nga drejtori i shkollës nga drejtori i drejtorisë së arsimit, andaj dhe propozon që kërkesëpadia të refuzohet.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i padiëses ka deklaruar se nga provat e paraqitura si nga pala padiëse ashtu edhe nga pala e paditur kontestohet faktikisht se pretendimet e padiësit për të drejtën në realizimin e tri pagave përcjellëse dhe tri pagave jubilarë nuk kanë bazë ligjore dhe as bazë të kontratës kolektive ngase bazuar në neni 51 të kontratës kolektive është konstatuar se të gjitha çështjet buxhetore financiare që burojnë nga kjo kontratë fillojnë të realizohen nga data 01.01.2015, kurse padiësi në pension ka dal më 01.10.2014, nga kjo rezulton se padiësi nuk mund të kërkojë të drejta më shumë se sa që mund ti fitojë në baza ligjore dhe në bazë të kontratës kolektive, kështu që Gjykatës i propozoj që kërkesëpadia e padiësit të refuzohet si e pa bazuar.

Për vërtetimin e drejtë të gjendjes faktike gjykata ka administruar këto prova: ka lexuar vendimin në emër të [REDAKTUAR] lëshuar nga Qeveria e Kosovës Ministria e Punës dhe Mirëqenjes Sociale i datës 15.10.2014, vendimi i Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave me nr.01-119-50977 i datës 04.01.2016, shkresa zyrtare me nr.126 të datës

08.04.2015, lëshuar nga Drejtoria e Arsimit- Komuna Ferizaj, procesverbali mbi vrojtimin në vend direkt për periudhën kohore 15.03.1975 deri më 30.09.2014, Libreza e punës me nr.13854/69, formulari për kërkesë apo ankesë e datës 04.06.2015, aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj C.nr.362/13 i datës 16.07.2016, formulari i të dhënave për listën e pagave në emër të [REDAKTUAR] i datës 03.10.2014.

Gjykata pas vlerësimit të pohimeve të palëve ndërgjyqëse dhe provave të lartcekura në kuptim të nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), me kujdes dhe ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha së bashku dhe ka gjetur se, Kërkesa e paditësit është e **pa bazuar**.

Gjykata me leximin e vendimit e Qeveria e Kosovës-Ministria e punës dhe Mirëqenjes Sociale, të datës 15.10.2014, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësi [REDAKTUAR], i është njohur e drejta në pension pas mbushjes së moshën 65 vjeqare.

Me leximin e vendimit të Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave me nr.01-119-50977 i datës 04.01.2016, nga ana e paditësit, është konstatuar fakti se paditësi ju është refuzuar ankesa, kundër përgjigjes së Drejtoris së Arsimit me të cilën paditësit ju është refuzuar lejimi i tri pagave përcjellëse me rastin e pensionimit.

Me leximin e shkresës zyrtare me nr.126 të datës 08.04.2015, lëshuar nga [REDAKTUAR] gjykata ka konstatuar faktin se kjo drejtori ka refuzuar kërkesën e paditësit [REDAKTUAR], për pagesën e shpërblimit të tri pagave jubilarë për në pension dhe tri pagave përcjellëse me rastin e pensionimit shumë totale prej 2316 €.

Me leximin e Libreza e punës me nr.13854/69, gjykata ka konstatuar faktin se paditësi ka qenë në marrdhënje pune për periudhën kohore 01.10.1969 e deri më 01.10.2014, me arritjen e moshës prej 65 vjet.

Me leximin e shkresës zyrtare me nr.126 të datës 08.04.2015, lëshuar nga [REDAKTUAR] gjykata ka konstatuar faktin se kjo drejtori ka refuzuar kërkesën e paditësit [REDAKTUAR] për pagesën e shpërblimit të tri pagave jubilarë për në pension dhe tri pagave përcjellëse me rastin e pensionimit shumë totale prej 2316 €.

Në bazë të gjendjes se vërtetuar faktike, gjykata erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditëses është e pabazuar dhe duhet të refuzohet. Këtë qëndrim gjykata e mori duke u bazuar në faktin se kërkesëpadia e paditëses për kompensimin e tri pagave jubilarë për në pension dhe tri pagave përcjellëse me rastin e pensionimit shumë të totale prej 2.316.00 €, është në kundërshtim me dispozitat ligjore, respektivisht me dispozitat e kontratës kolektive, përkatësisht me afatshmërinë e saj, ku sipas nenit 51 të kësaj kontrate e lidhur në mes SBASHK-ut, dhe MASHT-it me datë 11.04.2014, dispozitat e kësaj kontrate kolektive të cilat kanë komplikime financiare të kësaj kontrate fillojnë të zbatohen me datë 01.01.2015, andaj dispozita e kësaj kontrate nuk mund të zbatohen në këtë qështje juridike kontestimore. Duke marrë parasysh faktin se paditësi ka dalë në pension në me datë 01.10.2014 dhe se padia e paditëses në këtë gjykatë është parashtruar me datë 25.01.2016, e në anën tjetër kontrata kolektive ka filluar të zbatohet nga data 01.01.2015, të ardhurat të cilat paditësi i ka kërkuar në kërkesëpadi nuk i takojnë bazuar në nenin 90 të Ligjit të Punës ku parashihen kushtet e marrëdhënieve kolektive.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale u mor konform nenit 452.1 të LPK-së.

Nga të lartcekurat dhe bazuar në nenin 90 të Ligjit të punës, lidhur me nenin 143 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NE FERIZAJ

C.nr.69/16 më datë 06.09.2017



Gjyqtari,
Misin Frangu

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh, pas pranimit të kopjes së aktgjykimit, në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.